



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.00.2025 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 32/25 i datës 28.03.2025 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 32/25 i datës 28.03.2025 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet si në vijim:
 2. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 32/25 i datës 28.03.2025, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01 Nr. 00/25 i datës 29.05.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik 01 Nr. 32/25 i datës 28.03.2025 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.


Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.49/25

Datë:29.04.2025

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

